



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 87/12
Prishtinë, më 05.12.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic Naser Osmani, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Enver Peci, Kryesues i KGJK-së, Vehbi Behluli nga KGJK-ja, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami (GIZ), monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-139 për procedurën Përmbarimore me Raportin me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja theksoi se siq jeni njoftuar përmes email-it dhe keni marrë materialin, do të propozohet një pikë shtesë e rendit të ditës, që është: Shqyrtimi i Projekt-Kodit të Procedurës Penale, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për legjislacion.

Rendi i ditës miratohet njëzëri me plotësimin e një pike 4: Shqyrtimi i Projekt-Kodit të Procedurës Penale, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për legjislacion.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Kryetarja njoftoi se Komisioni ka pranuar një përfundim nga Kryesia e Kuvendit që e ngarkon për shqyrtimin e raportit financiar të KGJK-së për vitin 2011. Në bazë të Ligjit për KGJK-së, Këshilli Gjyqësor i raporton Kuvendit të Kosovës për punën në tij një vjeçare. Nëse e shikojmë raportin në shohim se ky institucion ka shfrytëzuar buxhetin rreth 87.9 %. Shihet se niveli më i ultë i buxhetit është për shpenzimet kapitale 60.27%, gjë që po ndodh me të gjitha institucionet përfshirë edhe ato të pavarura, dhe kjo mendoj është si pasojë e futjes së projekteve të paplanifikuara mirë dhe të padetalizuara.

Enver Peci të dhënat e prezantuara në raport, tregojnë rrjedhën e plotë të shpenzimeve të Këshillit. Prej Auditorit Gjeneral ne kemi marrë lëvdata për raportin. Sa i përket shpenzimeve kapitale, i kemi edhe ne ato probleme që po përballen edhe institucionet tjera, sa i përket ndërtimit të gjykatave ne varemi edhe prej komunave dhe prej procedurave se ku mund të ndërtohet gjykatë dhe po marrin kohë shumë të madhe .

Vehbi Behluli prezantoi shkurtimisht buxhetin e shpenzuar të Këshillit sipas kategorive ekonomike dhe për njësitë që janë pjesë e buxheti të KGJK-së si gjykatat e Kosovës, Zyra e Prokurorit Disiplinor, njësia për performancën gjyqësore, dhoma e posaqme e gjykatës supreme. Sa i përket investimeve kapital, deri të mos realizimi i projekteve të planifikuara ka ardhur për ka ardhur për disa arsye. Një ndër arsyet është se kemi pasur kërkesa nga ministria e financave për pezullimin e disa projekteve dhe në shtator ka ndodhur se ato projekte janë shkurtuar prej Thesarit. Për renovimin e gjykatës që është në ndërtesën e ish OSBE-së na janë ndarë dy kate dhe pasi që që nuk janë plotësuar të gjitha nevojat për vendosjen e stafit të Këshillit Gjyqësor, ne me marrëveshje i kemi dhënë një katë këshillit prokuroririal, që nuk kemi pa të arsyeshme me investue dhe është bërë një investim simbolik. Projekti për blerjen e automjeteve është realizuar këtë vit, sa i përket paisjes për audioincizim jemi në bisedime me donator për investime të përbashkëta.

Sali Asllanaj nga raporti shifet se shpenzimet më të ulta janë për investimet kapitale, që tashmë ofruar arsyet subjektive e të qëndrueshme. Ndoshta një vërejtje imja do të ishte shqyrtimi kaq vonë i raportit të vitit 2011, përndryshe përkrahu miratimin e tij.

Naser Osmani konsideroj se raporti financiar që e kemi përpara nuk paraqet ndonjë interesim kaq të madh për deputetët, sepse natyra e tyre e punës së këtij institucioni ka të bëjë me komisionin funksional. Janë pasqyruar në vija të trasha shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe u dhanë arsyetimit për shpenzimet kapitale dhe mendoj se duhet përkrahur atë.

Latif Gashi jam dakord me parafolësit edhe pse jemi vonë në shqyrtimin e raportit 2011 dhe me qenë se jeni për herë të parë këtu, herave tjera kishte qenë të ofroni një raport me të dhëna më të detalizuara, me pas një pasqyrë me reale për nënkategoritë dhe jo kështu i përgjithësuar.

Kryetarja me pajtohem me atë që tha z. Latif, raporti është shumë i përgjysmuar, pa të dhëna dhe kam një këshillë për KGJK-në që në raportin e viti tjetër, të ketë të dhëna më të detalizuara dhe të përfshihen të dhëna edhe për shpen, dhomës së posqame të gjykatës supreme dhe njësive tjera që janë brenda buxhetit të Këshillit.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-139 për procedurën Përmbartimore me Raportin me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja nëse shohim deklaratën financiare shohim se PL përmban implikime buxhetore në kohën kur është bërë vlerësimi financiar, por pas konsultimeve me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, kemi mësuar se kjo kosto është përfshirë në buxhetin e ministrisë për vitin 2013 dhe në planifikimet afatmeseme buxhetore.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për procedurën Përmbartimore dhe amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projekt-Kodit të Procedurës Penale, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për legjislacion

Kryetarja projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajn implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projekt-Kodi i Procedurës Penale dhe amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

5.1.**Kryetarja** lexoj propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me caktimin e pagave të anëtarëve të institucioneve dhe agjencioneve të pavarura, që do ti drejtohet Kryesisë së Kuvendit, sipas përfundimit të Kryesisë që ngarkoi komisionin të shqyrtojë këtë çështje dhe ti raportojë përsëri Kryesisë me rastin e hartimit të raportit të buxhetit 2013.

5.2.**Kryetarja** theksoi se projektligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor është miratuar në parim në senacën plenare, dhe kërkohet të caktojmë një grup punues për shqyrtimin dhe amendamentin e tij.

Në bazë të propozimeve, u caktuar grupi punues për shqyrtimin e Projektligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me këtë përbërje:

Hasime Krasniqi (kryesuese), Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami dhe Sevdije Lama.

5.1 **Kryetarja** theksoi se administrata e Kuvendit sugjeron se pas shqyrtimit të raportit për projektligje nga komisionet tjera të përhershme, ne si komision funksional duhet të votojmë raportin final që të figurojë data para së të dërgojmë në seancë plenare, që mendojë se nuk është e nevojshme pasi që do të ketë vetëm vonesa në procedimin e projektgjeve për miratim të dytë në Kuvend. Ne do të duhej të shqyrtonim vetëm nëse kemi vërejtje prej komisioneve tjera të përhershme

Naser Osmani komisionet tjera të përhershme nuk mundën me ndërhyj në raportin tonë, mundem me përkrah apo jo dhe nëse kanë vërejtje, vendos seanca, nuk ka arsye që të merremi ne prapë me atë.

Kryetarja ne si komision funksional presim rekomandimet e komisioneve tjera të përhershme dhe nëse ato bëjnë vërejtje duhet shqyrtuar prapë në komision dhe vendosim a e pranojmë vërejtjen apo jo. Përndryshe rekomandimet e komisioneve tjera i bëjmë pjesë e raportit final dhe nuk kemi çfarë e qesim për shqyrtim në komision prapë kur nuk ka vërejtje.

Hykmete Bajrami është procedurë ligjore se deri sa komisionet tjera nuk e dërgojnë rekomandimet e tyre brenda afatit ligjor, raporti ynë nuk konsiderohet final. Por ne duhet me bë një rregull, mos me i votue amendamentet dhe në fillim i dërgojmë në komisione tjera të përhershme dhe kur ti marrim rekomandimet e votojmë raportin me amendamentet.

Naser Osmani nuk ka kuptim me rikthye për një votim rishtazi çështjen dhe me votue dy herë për të njëjtën çështje dhe ne e kemi përfunduar punën në atë moment kur i kemi votue amendamentet.

Xhevdet Neziraj ajo çfarë pata me thënë u tha nga nënkryetari, por ndoshta duhet me pas për bazë komisionin për komunitete kur është fjala për raportin për buxhetin se ka deputetë që kanë propozuar kërkesa dhe mundën me ba vërejtje, por pse vendosim me u kthye në komision, na nxjerr telashe, por le të del në Kuvend edhe vendos Kuvendi.

Lati Gashi do të praktikohet praktika që është zbatuar deri më tani. Nëse komisionet tjera bëjnë vërejtje ne e shqyrojmë dhe deklarohejmë a pajtohejmë apo jo.

Kryetarja ju njoftojë se e kemi të përgaditur raportin final për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin për themelimin e sistemit të sigurimit të depozitave në Kosovës dhe komisionet tjera e kanë shqyrtuar dhe nuk kanë bërë ndonjë vërejtje dhe do të procedohet për shqyrtim dhe miratim të dytë në senacë plenare.

Mbledhja përfundoi: 11:35

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona